



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Ministria e Financave inkurajon çdo subjekt, punonjës të administratës publike, person fizik apo juridik, si edhe çdo person anonim, që të denoncojë çdo parregullsi apo veprim korruptiv që gjykon se ka ndodhur me fondet publike, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe ndëshkimin e individëve përgjegjës.

Ligji nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”, ka sanksionuar ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të inspektimit financiar publik në Ministrinë e Financave, i cili në objekt të punës së vet ka mbrojtjen e interesave financiare të njësive publike, kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Inspektimi financiar publik e shtrin fushën e veprimtarisë në:

- njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
- shoqëritë shtetërore, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;
- çdo person fizik apo juridik, vetëm për fondet që përfiton nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Europian apo fondet në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku përfitues është shteti shqiptar.

Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik, si autoritet i ngarkuar nga ligji, shqyrton dhe vlerëson çdo kërkesë, informacion apo ankesë që lidhet me parregullsi në përdorimin e fondeve publike me qëllim:

- të përcaktojë shkeljet e akteve normative, si dhe të provojë dyshimet për mashtrimet e kryera;
- të zbulojë parregullsitë dhe dëmet e shkaktuara në pronën e njësive publike;
- të identifikojë individët përgjegjës për shkeljet e kryera dhe të kërkojë marrjen e masave zhdëmtuese, administrative apo disiplinore, sipas shkallës apo llojit të përgjegjësisë.

Kur të dhënat tregojnë dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një vepre penale, Sekretari i Përgjithshëm bën kallëzim me shkrim në prokurori.

Kërkesat, informacionet dhe ankesat, paraqiten me shkrim dhe dorëzohen në protokollin e Ministrisë së Financave nëpërmjet rrugës postare apo dorazi, në adresën: Ministria e Financave; Bulevardi Dëshmorët e Kombit; nr.3; Tiranë.